



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
10.2.2021

Me datë 10.2.2021, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Në mbështetje të Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", ligjit nr.15/2016" Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive, mbledhja u zhvillua online. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Nersada Mandija, Aurora Dibra, Ardiana Ndreu, Diana Muriqi, Jona Leqejza, Sabahet Lishi, Vjollca Petani, Dhurata Tyli, Sabina Danaj, Donika Ndoja, Kristi Shllaku, Valbona Doniku, Suada Selimaj, Lumnije Guri, Ornela Leka, Luan Heta, Elson Çeliku, Oltion Luli, Anton Kaftalli, Hilmi Lakti, Avenir Çelaj, Marjan Ndërshtiqaj, Gerald Hasaj, Lush Marku, Julian Kraja, Lulash Nika, Hekuran Gjorreta, Besmir Vukaj, Anton Deda, Blerim Dimnaku, Gjergj Sokoli.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim "Për miratimin e bursave për nxënësit e vitit të parë dhe të viteve të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin shkollor 2020-2021"
2. Diskutime jashtë rendit të ditës

1.Mbledhja vijon me paraqitjen e rendit të ditës nga Kryetarja e Këshillit, nuk ka diskutime. Vijohet me miratimin e rendit të ditës nga ana e këshilltarëve, ku në përfundim të procesit të votimit, rendi i ditës miratohet me 29 voto Pro, 0 Abstenim, 0 Kundër.

2.Mbledhja vijon me projektvendimin "Për miratimin e bursave për nxënësit e vitit të parë dhe të viteve të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin shkollor 2020-2021". ku fjala i jepet Drejtores së Drejtorisë Ekonomike të Arsimit së Bashkisë znj. Aulida Anamali, e cila relatton sipas materialit të përgatitur. Znj. Anamali paraqet projekt aktin dhe një shtesë në projekt akt për një nxënës për të cilin është paraqitur dokumentacioni nga drejtoria rajonale e shërbimit social me date 26.1.2021 dhe i plotëson kriteret.

Në emër të komisionit të kontrollit financiar i kërkohet mendim këshilltares, Znj. Jona Leqejza, njëherazi edhe kryetare e komisionit e cila relatton në bazë të materialit të

përgatitur nga komisioni dhe citon observacionet e kryera nga procesi i verifikimit për 348 dosjet e aplikantëve për bursë. Komisioni bie dakord me 189 bursat e aprovuara dhe e quan procesin korrekt, bie dakord me faktin që 141 aplikantë nuk plotësojnë asnjë nga kriteret e VKM 666 dhe janë trajtuar në formë korrekte duke mos i njohur të drejtën e bursës, dhe ndalet tek 18 dosje aplikantësh të cilat komisioni i ka marrë në shqyrtim të hollësishëm. Nga këto 18 dosje, 13 sipas gjykimit të komisionit i plotësojnë kriteret, apo janë gjykuar mbi kriteret dhe kategoritë jo të duhura, dhe dokumentacioni i paraqitur është i mjaftueshëm për ti aprovuar të drejtën e bursës, dhe 5 prej tyre, të cilave u është lënë afat për plotësim dokumentësh deri me 4 shkurt 2021, 3 rezultojnë se u takon e drejta e përfitimit të bursës. Për këtë arsye, komisioni propozon një ndryshim të projekt aktit për të përfshirë 16 aplikantët në fjalë si përfitues burse. Gjithashtu, komisioni shpalos disa rekomandime për thjeshtimin e procedurave për vitin e ardhshëm, sidomos për aplikuesit përfitues të ndihmës ekonomike, aplikuesit me invaliditet vetjak apo prindëror si dhe ato që vijnë nga shtresa të marginalizuara, pasi është esenciale që këto të kenë mundësi dhe stimul të frekuentojnë shkollën.

Kryetarja e Këshillit u drejtohet Këshilltarëve nëse kanë diskutime dhe observacione specifike për këtë projekt akt. Këshilltari Lush Marku kërkon sqarim mbi cilat shtesa të projekt aktit do votohet. Kryetarja e Këshillit sqaron se do votohet Projekt akti i ardhur nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit, me një shtesë të datës 26.1.2021 si dhe propozimin e Komisionit i Kontrollit Financiar në kërkesën e tij për një shtesë në projekt akt. Nuk ka diskutime të tjera.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 30 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### Miratohet

Vijohet në diskutimet jashtë rendit të ditës ku kërkon fjalën Z. Hilmi Lakti.

Z. Lakti shprehet se është mjaft i zhgënjyer nga trajtimi politik i situatës së përmbytjeve në zonën e anës së malit dhe njërive afër lumit Buna. Ai kërkon që të ishte Kryetarja e Bashkisë prezente në Këshill dhe të relatojë e informojë mbi çfarë masash ka marrë Bashkia për këtë situatë pasi Këshilli Bashkiak ka miratuar një fond emergjence prej 84 milion lekë dhe nuk ka transparencë çfarë është bërë me të, pas thirrjeve dhe kërkesave të shumta me shkrim nga Këshilli. Gjithashtu, Z. Lakti përmend të gjithë kontributet që janë bërë nga buxheti i shtetit nëpërmjet ministrive të linjës dhe donatorëve bamirës, të cilëve nuk po u njihet as kontributi madje po reklamohet si i Bashkisë. Z. Lakti bën thirrje që të shmangen ndasitë politike dhe të gjithë palët të jenë bashkëpunues për të ndihmuar këto banorë në fatkeqësi.

Në vijim, fjalën e kërkon Znj. Ndreu e cila referon një problem të rëndësishëm të shërbimeve publike, ku Bashkia Shkodër ka refuzuar lejen për Operatorin e Shërbimit Elektrik për ndërhyrje në rrjet në zonat Trush, Dobraq, e shumë të tjera dhe për pasojë ndikuar negativisht në cilësinë e marrjes së shërbimit nga banorët. Znj. Ndreu bën thirrje Kryetares së Bashkisë të lirojë procedurat në mënyrë që Operatori të mund të vazhdojë punën.

Pasi pyet nëse ka diskutime të tjera, fjalën e merr Kryetarja e Këshillit, e cila flet mbi moszbatimin nga ana e Bashkisë për VKM 1149 datë 24.12.2020 i cili parashikon një shtesë page për punonjësit e institucioneve të arsimit parauniversitar. Në janar 2021 ka filluar efekti financiar i këtij vendimi dhe rezulton se për punonjësit përfitues të arsimit parashkollor, punonjësit e konvikteve, dhe ato të qendrave kulturore qe janë të gjitha në varësi të njësisë së vetqeverisjes vendore. kjo rritje nuk është reflektuar në pagën e muajit janar dhe nuk është marrë asnjë shpjegim për arsyen. Kryetarja e Këshillit bën thirrje administratës të marrë masa të reflektojë këtë ndryshim në paga sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Nuk ka diskutime të tjera.

Nga ana e Kryetares së Këshillit mbledhja deklarohet e mbyllur

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 10.2.2021. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio (DVD)*

Procesverbali përmban 3 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

**Sekretar**

**Denis LESHA**

**KRYETARE**

**Brigjela KADIJA**



**KRYETAR I GRUPIT PSD**

**Gjergj SOKOLI**

**KRYETAR I GRUPIT PS**

**Aurora DIBRA**